



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2544/ 4 prot.

Datë 31.10.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1108/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt: *“Blerje orendi dhe pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”* me fond limit 35,203,770 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “RO-AL” SHPK, me NIPT: J61811001M  
Adresa: Km.8, Autostrada Tiranë-Durrës, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara Adresa: Blv  
”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” me fond limit 35,203,770 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tre mijë e

shtatëqind e shtatëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datë 22.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 06.10.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BUNA SHPK	0.00	Skualifikuar
2. E M K O SHPK	0.00	Skualifikuar
<b>3. "RO -AL" SHPK</b>	<b>26,999,676.00 lekë</b>	<b>Kualifikuar</b>
4. KLAME SHPK	28,857,066.00 lekë	Kualifikuar
5. BOLT SHPK	29,064,990.00 lekë	Kualifikuar
6. ERZENI/SH SHPK	30,423,960.00 lekë	Kualifikuar
7. MUCA SHPK	31,621,115.00 lekë	Kualifikuar
8. SHAGA SHPK	35,124,421.60 lekë	Skualifikuar

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.10.2023, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BUNA SHPK	0.00	Skualifikuar
2. E M K O SHPK	0.00	Skualifikuar
<b>3. "RO -AL" SHPK</b>	<b>26,999,676.00 lekë</b>	<b>Skualifikuar</b>
4. KLAME SHPK	28,857,066.00 lekë	Kualifikuar
5. BOLT SHPK	29,064,990.00 lekë	Kualifikuar
6. ERZENI/SH SHPK	30,423,960.00 lekë	Kualifikuar
7. MUCA SHPK	31,621,115.00 lekë	Kualifikuar
8. SHAGA SHPK	35,124,421.60 lekë	Skualifikuar

II.5. Operatori ekonomik "RO -AL" SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *"Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3, seksioni 2.3 "Kapaciteti Teknik" i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (shënimi 3.1). Bazuar në këtë kriter, ofertuesi ka deklaruar se disponon 5 mjete transporti, nga të cilat 3 në pronësi dhe 2 me qira. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar, sipas "Kërkesës për dorëzim dokumentacioni" datë 06.10.2023, rezultoi se, për mjetin me targë ACR124, i deklaruar me status "qira" në ditën e hapjes së ofertave në SPE, ofertuesi ka paraqitur dy kontrata noteriale*

me të njëjtin nr. Rep, nr. Kol dhe të njëjtën datë, të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Sipas kontratës së qirasë me Nr. Rep 4226, Nr. kol. 2710 datë 14.09.2023 të paraqitur në SPE në ditën e hapjes së ofertave dhe në formë të shkruar të njehsuar me origjinalin me nr. 4761 rep, datë 09.10.2023 administruar pranë AK me nr. 1305 prot., datë 10.10.2023, rezulton se ofertuesi ka marrë me qira automjetet: AA 173 MR Daimler Chrysler Nr. Shasie WDB9036131R429224; AA 560 XY Renault Premium Nr. Shasie VF611A155FD000488; AA 851 LG DAF E47 Nr. Shasie XLRTE47MSOE793496; AA 768 NE DAF TE47 Nr. Shasie XLRTE47MS7E765548; AA 284 HR DAF TE47 Nr. Shasie XLRTE47MSOE797056, ndërsa sipas kontratës së qirasë me të njëjtin Nr. Rep 4226, Nr. kol. 2710 datë 14.09.2023 të paraqitur në kopje të njehsuar me origjinalin nr. 4818 rep, datë 11.10.2023 e administruar pranë AK me nr. 1305/1 prot., datë 11.10.2023 rezulton se, ofertuesi ka marrë me qira automjetin me targa ACR124 nr. Shasie WKOS0002400080879. Këto 2 kontrata me të njëjtin nr. Rep, nr. Kol dhe të njëjtën datë, por me objekt të ndryshëm kontrate, të hartuara nga notere A.K. dhe të njehsuara si të njëjta me origjinalin po nga e njëjta notere A. K. (me nr. 4761 rep, datë 09.10.2023 dhe nr. 4818 rep, datë 11.10.2023), bien në kundërshtim me njëra tjetrën, dhe si rrjedhim, cenojnë vlefshmërinë e ofertës si edhe besueshmërinë e ofertuesit. Neni 76, pika 5 e LPP, parashikon se, autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në APP, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. Bazuar në paragrafin e fundit të Shtojcës 7 të DST, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

II.5. Në datën 18.10.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2544 prot., datë 18.10.2023 e operatorit ekonomik “RO -AL” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2544/2 Prot., date 19.10.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Me shkresën nr. 1337/4 prot., datë 26.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 2544/3 prot., datë 30.10.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “RO -AL” SHPK. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor **e ka refuzuar ankesën** e operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### Arsyeton:

III.1. Në datën 07.09.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt: *“Blerje orendi dhe pajisje mobilimi” për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara” Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*” me fond limit 35,203,770 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

III.1.1. Në datë 22.09.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 06.10.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BUNA SHPK	0.00	Skualifikuar
2. E M K O SHPK	0.00	Skualifikuar
<b>3. "RO -AL" SHPK</b>	<b>26,999,676.00 lekë</b>	<b>Kualifikuar</b>
4. KLAME SHPK	28,857,066.00 lekë	Kualifikuar
5. BOLT SHPK	29,064,990.00 lekë	Kualifikuar
6. ERZENI/SH SHPK	30,423,960.00 lekë	Kualifikuar
7. MUCA SHPK	31,621,115.00 lekë	Kualifikuar
8. SHAGA SHPK	35,124,421.60 lekë	Skualifikuar

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 13.10.2023 ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BUNA SHPK	0.00	Skualifikuar
2. E M K O SHPK	0.00	Skualifikuar
<b>3. "RO -AL" SHPK</b>	<b>26,999,676.00 lekë</b>	<b>Skualifikuar</b>
4. KLAME SHPK	28,857,066.00 lekë	Kualifikuar

5. BOLT SHPK	29,064,990.00 lekë	Kualifikuar
6. ERZENI/SH SHPK	30,423,960.00 lekë	Kualifikuar
7. MUCA SHPK	31,621,115.00 lekë	Kualifikuar
8. SHAGA SHPK	35,124,421.60 lekë	Skualifikuar

III.1.4. Operatori ekonomik “RO -AL” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” i Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit (shënimi 3.1). Bazuar në këtë kriter, ofertuesi ka deklaruar se disponon 5 mjete transporti, nga të cilat 3 në pronësi dhe 2 me qira. Pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar, sipas “Kërkesës për dorëzim dokumentacioni” datë 06.10.2023, rezultoi se, për mjetin me targë ACRI24, i deklaruar me status “qira” në ditën e hapjes së ofertave në SPE, ofertuesi ka paraqitur dy kontrata noteriale me të njëjtin nr. Rep, nr. Kol dhe të njëjtën datë, të cilat bien në kundërshtim me njëra tjetrën. Sipas kontratës së qirasë me Nr. Rep 4226, Nr. kol. 2710 datë 14.09.2023 të paraqitur në SPE në ditën e hapjes së ofertave dhe në formë të shkruar të njehsuar me origjinalin me nr. 4761 rep, datë 09.10.2023 administruar prans AK me nr. 1305 prot., datë 10.10.2023, rezulton se ofertuesi ka marrë me qira automjetet: AA 173 MR Daimler Chrysler Nr. Shasie WDB9036131R429224; AA 560 XY Renault Premium Nr. Shasie VF611A155FD000488; AA 851 LG DAF E47 Nr. Shasie XLRTE47MSOE793496; AA 768 NE DAF TE47 Nr. Shasie XLRTE47MS7E765548; AA 284 HR DAF TE47 Nr. Shasie XLRTE47MSOE797056, ndërsa sipas kontratës së qirasë me të njëjtin Nr. Rep 4226, Nr. kol. 2710 datë 14.09.2023 të paraqitur në kopje të njehsuar me origjinalin nr. 4818 rep, datë 11.10.2023 e administruar pranë AK me nr. 1305/1 prot., datë 11.10.2023 rezulton se, ofertuesi ka marrë me qira automjetin me targa ACRI24 nr. Shasie WKOS0002400080879. Këto 2 kontrata me të njëjtin nr. Rep, nr. Kol dhe të njëjtën datë, por me objekt të ndryshëm kontrate, të hartuara nga notere A.K. dhe të njehsuara si të njëjta me origjinalin po nga e njëjta notere A. K. (me nr. 4761 rep, datë 09.10.2023 dhe nr. 4818 rep, datë 11.10.2023), bien në kundërshtim me njëra tjetrën, dhe si rrjedhim, cenojnë vlefshmërinë e ofertës si edhe besueshmërinë e ofertuesit. Neni 76, pika 5 e LPP, parashikon se, autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në APP, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji. Bazuar në paragrafin e fundit të Shtojcës 7 të DST, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.*

III.1.5. Në datën 18.10.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2544 prot., datë 18.10.2023 e operatorit ekonomik “RO -AL” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 2544/2 Prot., date 19.10.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

III.1.7. Me shkresën nr. 1337/4 prot., datë 26.10.2023 protokolluar me tonën me nr. 2544/3 prot., datë 30.10.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacion lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “RO - AL” SHPK. Nga informacioni i mësipërm rezulton, se autoriteti kontraktor **e ka refuzuar ankesën** e operatorit ekonomik ankimues.

III.1.8. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor ende nuk ka publikuar as njoftimin e fituesit, as njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.*

***Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.***

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.1.11. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *“1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.12. Në nenin 97, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet:

“2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.13. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar qartë në nenin 110, pikat 2 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues “RO-AL” SHPK ka dorëzuar në datën 18.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesën, protokolluar me nr. 2544 prot., datë 18.10.2023. Ndërkohë nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor ende nuk është publikuar as njoftim - fituesi, as njoftimi i anulimit të procedurës objekt - ankimi. Procedura vijon të jetë në fazën vlerësimit të ofertave, fazë e cila ka përfunduar më datë 13.10.2023.

Në nenin 82, pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, përpara afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datë 18.10.2023 (data që



operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesën në KPP) nuk është publikuar akoma njoftimi i fituesit/anulimit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, në datë 18.10.2023, afati i paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, llogaritja e afatit për ankim nuk ka filluar ende, për sa kohë nuk është publikuar njoftimi i fituesit të procedurës së prokurimit, apo njoftimi i anulimit të saj, që do të thotë se operatorit ekonomik ankimues nuk i ka lindur akoma e drejta e ankimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 18.10.2023, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

III.1.14. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770 (tridhjetë e pesë milion e dyqind e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) Lekë

pa TVSH, zhvilluar në datën 22.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “RO-AL” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Anila Malaj</b>
	<b>Kryetar</b>	
	<b>Jonaid Myzyri</b>	